

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, me zyrtares ligjore, Hikmete Veliu-Pajaziti, në lëndën penale ndaj të akuzuarit K. Xh nga Gj, të cilin me autorizim e mbron av.H. A për veprën penale, Ngacmimi, nga neni 186 par. 1 i KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II nr.418/2017, e datës 15.03.2017, e sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, të datës 21.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar e publik, më datën 10.05.2017, mori dhe në prezencë të palëve shpalli, ndërsa më datë 11.05.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari K. Xh, nga babai N dhe nëna S, e lindur D, i lindur më datë ..në Gj, jeton në fsh..., i pamartuar, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse, nga data..., e deri më dt..., me dashje dhe qëllim të ngacimit, shqetësimit, frikës dhe ndjenjës së pasigurisë me sjelljen dhe komunikimin e tij të vazhdueshëm, për shkak të refuzimit për një lidhje nga e dëmtuara D. S, ka vënë nën presion të vazhdueshëm ate, ashtu që, në mënyrë të vazhdueshme ka shkruar në emër dhe adresë të saj, përmes rrjetit social "...", duke hapur adresa të ndryshme në emër të të dëmtuarës, duke u shkruar vëllait dhe motrës së saj, përmes telefonit dhe rrjetit social "", komunikimin e tij të vazhdueshëm përmes "" dhe përcjelljes e vëzhgimit deh në këtë mënyrë, tek e njëjta ka shkaktuar frikë dhe shqetësim të madh emocional

-me çka ka kryer veprën penale, **Ngacmimi**, nga neni 186 par.1 të KPRK-së, andaj, Gjykata, bazuar në dispozitat e neneve 7,17,21,51,73,114,të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 dhe 463 të KPPRK-së, i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit K. Xh., me dënim burgu në kohëzgjatje prej **4 (katër) muaj**, në të i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1(një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Udhëzohet pala e dëmtuar **D. S** në kontest juridiko-civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që të **paguaj** shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej **20 (njëzetë) €**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzë PP.II nr.571/2017, e datës 21.04.2017, kundër të akuzuarit B. R, për vepër penale, lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 nën par. 4.1 lidhur me par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.

Prokuroria Themelore, Departamenti i Përgjithshëm në Gjiilan, përmes prokurores së shtetit Bahtie Ademi, kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me të pandehurin dhe mbrojtësin e tij

Prokurorja e shtetit Huma Jetishi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë të mbajtur më datë 28.04.2017, deklaroi se për një gjë të tillë kanë pasur autorizim edhe nga kryeprokurori dhe këtë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë e kanë nënshkruar së bashku duke përfshirë këtu kryeprokurorin, të pandehurin, mbrojtësin e tij dhe prokurorja në fjalë, andaj, kërkojnë nga gjykata që ta pranojë marrëveshjen me nr. PP.II.nr.571/2017 të datës 21.04.2017.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. G. S deklaroi se mbetet pranë marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe kërkoi nga gjykata që ta pranojë këtë marrëveshje.

I pandehuri deklaroi se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit së tij, pasi që marrëveshjen për pranimin e fajësisë e ka nënshkruar në mënyrë vullnetare, i vetëdijshëm se çka përmban e njëjta, paraprakisht është konsultuar me mbrojtësin e tij, është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale ndërsa nuk ka qenë i kërcënuar apo mashtruar për ta nënshkruar këtë marrëveshje, andaj edhe ky kërkoi nga kjo gjykatë që ta pranojë këtë marrëveshje. Gjithashtu në fjalën përfundimtare deklaroi se është penduar dhe në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm të mos bie ndesh me ligjin.

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë, mori aktvendim me të cilin e pranoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, dhe i njoftoi palët se pasi që marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është arritur me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë, nuk i lejohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, e as prokurores së shtetit që të tërhiqen nga kjo marrëveshje mbi pranimin e fajësisë pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 233 par. 18 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari pati sjellje korrekte në Gjykatë, se është penduar për veprën në fjalë, ndërsa si rrethanë rënduese, mori parasysh rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe dëmin e shkaktuar nga i pandehuri, me bindje se një dënim i tillë është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me të do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK -së.
Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 390/2017, më datë 04.05.2017**

Praktikantja
Albana Islami

Gjykatësja e vetme gjykuese
Luljete Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Palët kanë hequr dorë nga ankesa kundër këtij aktgjykimi.